

VENDIM

Nr. 6, Datë 15.05.2012

PËR MIRATIMIN E TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT TË PROGrameve TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2012 – 2013

Këshilli i Administrimit i Universitetit të Arteve në mbledhjen e tij të datës 15.05.2012, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe pas diskutimeve të anëtarëve,

VËREN SE

Tarifa e studimit përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me propozimet e paraqitura nga IAL publike. Në këtë këndvështrim UART ka detyrimin që për programet e studimit që zhvillohen në këtë shkollë të paraqesë propozimet e veta lidhur me tarifën e shkollimit për programet e veçanta të studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, për çdo Fakultet. Statuti i Universitetit të Arteve, përcakton në nenin 9, pika2, germa gj se tarifa e shkollimit miratohet paraprakisht nga Senati Akademik dhe më pas kalon në Këshillin e Administrimit. Pas miratimit edhe nga Këshilli i Administrimit, tarifat i propozohen Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për vazhdimin e procedurave të mëtejshme ligjore. Fakultetet e UART kanë paraqitur zyrtarisht vlerën e tarifës vjetore të shkollimit për programet e studimit në secilin prej tyre. Senati Akademik ka dhënë miratimin për tarifat e studimit me Vendimin nr. 12, datë 11.04.2012. Për sa më sipër, Këshilli i Administrimit i UART,

VENDOSI

1. Miratimin e tarifës vjetore të shkollimit për secilin program studimi në Universitetin e Arteve, sipas Lidhjes 1, bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE



LIDHJA 1

Nr. rend	Fakulteti	Programi i studimit	Tarifa vjetore e studimeve
Fakulteti i Muzikës			
1.		Kompozim	30.000
2.		Muzikologji	30.000
3.		Dirizhim	30.000
4.		Piano	30.000
5.		Violinë	30.000
6.		Violonçel	30.000
7.		Violë	30.000
8.		Kitarë	30.000
9.		Kontrabas	30.000
10.		Flaut	30.000
11.		Oboe	30.000
12.		Klarinetë	30.000
13.		Fagot	30.000
14.		Korno	30.000
15.		Trombë	30.000
16.		Trombon	30.000
17.		Bastub	30.000
18.		Këngëtar	30.000
19.		Pedagogji Muzikore	30.000
20.		Fizarmonikë klasike	30.000
Fakulteti i Artit Skenik			
1.		Aktrim	30.660
2.		Regji	30.660
3.		Skenografi dhe Kostumografi	30.660
4.		Koreografi	30.660
5.		Regji filmi dhe TV	50.000
Fakulteti i Arteve të Bukura			
1.		Pikturë tekstili & modë	30.000
2.		Pikturë kavaleti	30.000
3.		Pikturë multimedia	30.000
4.		Pikturë monumentale	30.000
5.		Pikturë grafike	30.000
6.		Skulpturë	30.000
7.		Skulpturë qeramike	30.000